



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.4, nenin 30 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Rregulloren 12/2022 Për Procedurën e Zgjedhjes, Emërimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, si dhe Vendimit KGJK Nr. 192/2023 të datës 18 Maj 2023, shpall:

KONKURS

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

GJYQTAR MBIKËQYRËS

Kriteret formale kualifikuese për aplikim;

1. Për kandidatin për kryetar të gjykatës dhe gjyqtar mbikëqyrës mund të aplikoj vetëm gjyqtari që vjen nga radhët e gjykatës përkatëse, duke përfshirë edhe degët e saj.
2. Kandidati për kryetar të gjykatës, respektivisht gjyqtar mbikëqyrës duhet të plotësoj kriteret themelore si në vijim:
 - 2.1 të jetë gjyqtar me mandat të përhershëm;
 - 2.2 të mos ketë sanksion disiplinor me vendim të formës së prerë, përjashtimisht masën vërejtje jo publike me shkrim;
 - 2.3 të mos ketë aktakuzë të konfirmuar për ndonjë vepër penale, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 2.4 të mos jetë i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë, përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia;
 - 2.5 të ketë së paku shkallë vlerësimi të performancës “shumë mirë”.

Kandidatët të cilët nuk kanë të drejtë aplikimi;

1. Të drejtë për aplikim për pozitën kryetar gjykatë apo gjyqtar mbikëqyrës nuk kanë:
 - 1.1 anëtari i Këshillit, gjatë ushtrimit të mandatit të tij si dhe pas përfundimit të mandatit brenda periudhës kohore të përcaktuar me legjislacionin në fuqi;
 - 1.2 kryetari i Gjykatës përkatëse i cili ka përfunduar mandatin e tij si kryetar i asaj gjykatë, për pozitën si kryetar gjykatë;
 - 1.3 gjyqtari mbikëqyrës i cili ka përfunduar mandatin e tij si gjyqtar mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për pozitën si gjyqtar mbikëqyrës në Dhomën e Posaçme, si dhe gjyqtari mbikëqyrës në degë të gjykatës themelore për pozitën gjyqtar mbikëqyrës në degë.

Kriteret Vlerësuese;

1. Kandidati për kryetar të gjykatës / gjyqtar mbikëqyrës përveç profesionalizmit dhe kualifikimeve për kryerjen e funksionit, duhet të ketë aftësi dhe njohuri në kryerjen e punëve të udhëheqjes dhe organizimit brenda gjykatës / degës sipas kriterëve në vijim:
 - 1.1 njohjen e punëve të administratës gjyqësore;
 - 1.2 të qenit kreativ në punë duke lehtësuar punën e gjykatës /degës;
 - 1.3 komunikimin korrekt me palë dhe kolegë brenda gjykatës / degës;
 - 1.4 gatishmërinë për bashkëpunim me organizata dhe institucione tjera.
2. Vlerësimi i kriterëve nga paragrafi 1 i këtij neni, të kandidatit për kryetar gjykatë /gjyqtar mbikëqyrës bëhet përmes intervistës me gojë.
3. Përveç, kriterëve vlerësuese të parapara me paragrafin 1 të këtij neni, Komisioni vlerësues do të vlerësoj edhe koncept dokumentin me shkrim të dorëzuar nga kandidati me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse dhe do të marrë në konsideratë trajnimet e specializuara, përvojën menaxheriale, vlerësimin e performancës dhe reputacionin të cilin kandidati gëzon nga ana e kolegëve gjyqtarë.
4. Koncept dokumenti tregon vizionin e kandidatit për mënyrën e menaxhimit të gjykatës / degës si dhe ngritjes së efikasitetit në bazë të resurseve ekzistuese, i cili duhet të përmbaj:
 - 4.1 vizionin në lidhje me rregullat dhe strategjitë që duhet implementuar në gjykatë / degë gjatë mandatit të tij;
 - 4.2 vizionin për menaxhimin e gjykatës / degës duke përfshirë planin për reduktimin e lëndëve të mbetura dhe masa të tjera për rritjen e efikasitetit të gjykatës / degës.
5. Koncept dokumenti sipas paragrafit 4 të këtij neni, duhet të ketë jo më pak se tre (3) dhe jo më shumë se shtatë (7) faqe.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Data e fillimit të aplikimi: 02 QERSHOR 2023

Data e fundit të aplikimit: 16 QERSHOR 2023

Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit në:

Sekretariatit e KGJK-së, Rruga ‘Luan Haradinaj’ nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit.

RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Kandidatëve që aplikojnë për pozitën përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e -mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.